

Kart' e-parë e-përgjithëshme e apostollit Joan.

Krye 1.

- 1 Atë që ishte që ndë kryet, atë që kemi dëgjuarë, atë që kemi parë më sytë t'anë, atë që vumë re, edhe duartë t'ona e preknë, për
- 2 Fjalën' e jetësë; (Edhe jeta uçaq, edhe e pamë edhe dëshmojmë, edhe u apënë juve zë për jetën'e-përjetëshme, që ishte tek Ati, edhe uçaq
- 3 ndër ne;) Atë që kemi parë edhe kemi dëgjuarë, për atë u apëmë zë juve, që të keni edhe ju pjesë me ne; edhe pjesa jonë është me Atin' edhe me Birin' e ati Jisu Krisht.
- 4 Edhe këto u'a shkruajmë juve, që të jet' i-plotë gëzimi juaj.
- 5 Edhe ky është zëri që kemi dëgjuarë nga ay, edhe u apëmë zë juve, Se Perëndia është dritë, edhe nukë ka ndonjë errësirë tek ay.
- 6 Ndë thëncimë së kemi pjesë me atë, edhe ecëjmë nd' errësirët, gënjejmë, edhe nukë
- 7 bëjmë të-vërtetënë. Po ndë ecëshimë ndë dritët, sikundrë ay është ndë dritët, kemi pjesë njëri me tjetërinë, edhe gjaku i Jisu Krishtit, Birit t'ati, na qëron nga çdo faj.
- 8 Ndë thëncimë se s' kemi faj, kobojmë vetëhen' t'ënë, edhe e-vërteta nuk' është ndër
- 9 ne. Ndë rrëfeshimë fajetë t'anë, është be-

sëtar edhe i-drejtë, që të na ndjenjë fajetë
10 edhe të na qëronjë nga çdo shtrëmbëri. Ndë
thëncimë se s' kemi fëjyerë, e bëjmë atë
gënjeshhtar, edhe fjal' e ati nuk' është ndër ne.

Krye 2.

- 1 Djemthit' e mi, u shkruanj juve këto, që të
mos fëjeni; edhe nde fëjftë ndonjë, kemi kush
2 të lutetë tek Ati, Jisu Krishtin' e-drejtë. Edhe
ay është çpërblimi për fajetë t'anë; edhe jo
vetëmë për t'anëtë, po edhe për të-gjithë
botësë.
- 3 Edhe nga këjo e dimë, se e kemi njohurë
4 atë, ndë ruajçimë porosit' e ati. Ay që tho-
të, E kam njohur' atë, edhe s'ruan porosit' e
ati, është gënjeshhtar, edhe e-vërteta nuk'
5 është mb' atë; Po ay që ruan fjalën' e ati,
me të-vërtetë dashuria e Perëndisë është e-
mbaruarë te ky. Nga këjo e dimë, se jemi
6 mb' atë. Ay që thotë se mbetetë mb' atë, ka
detyrë, sikundrë eci ay, edhe ky kështu të
ecënjë.
- 7 Vëllezër, nuk' u shkruanj juve porosi të-re,
po porosi të-vjetërë, atë të-cillënë e kishitë
që ndë kryet; porosia e-vjetërë është fjala
8 që dëgjuatë që ndë kryet. Përsëri u shkruanj
juve një porosi të-re, e-cila gjë është e-vërtetë
mb' atë edhe mbë ju; sepse errësira shkon, edhe
9 drita e-vërtetë po ndrit. Ay që thotë se është

- ndë dritët, edhe i ka mëri të vëllat, nd' errë-
10 sirë është gjer tashi. Ay që do të vëllanë
mbetetë ndë dritët, edhe skandhali nukë ka
11 tek ay. Po ay që i ka mëri të vëllat, nd' e-
rrësirëtecën, edhe nukë di se ku vete, sepse
errësira i verboj sytë.
- 12 U shkruanj juve, djemthit' e mi, se undjenë
13 fajetë t'uaj për emërin' e ati. U shkruanj juve,
atër, sepse e keni njohur' atë që është që
ndë kryet; u shkruanj juve, djaloshë, se e
keni mundurë të-ligunë; u shkruanj juve, çuna,
14 sepse e keni njohurë Atinë. U shkrova juve,
atër, sepse e keni njohur' atë që është që
ndë kryet; u shkrova juve, djaloshë, sepse
jeni të-fortë, edhe fjal' e Perëndisë mbetetë
ndër ju, edhe e keni mundurë të-ligunë.
- 15 Mos doni botënë, as ato që janë ndë botët.
Ndë do ndonjë botënë, dashuria e Atit nuk'
16 është mb' atë. Sepse çdo gjë që është ndë
botët, dëshërimi i mishit, edhe dëshërimi i
syvet, edhe madhështia e jetësë, nuk' është
17 prej Atit, po është prej botësë. Edhe bota
shkon, edhe dëshërim' i asaj; po ay që bën
dashurimin' e Perëndisë mbetetë ndë jetët
të-përjetëshme.
- 18 Cuna, është or' e fundit; edhe sikundrë
dëgjuatë, se antikrishti vjen, edhe tashi
shumë antikrishtër ka; andaj dimë, se është
19 or' e fundit. Prej nesh duallnë, po nuk
ishinë prej nesh; sepse, ndë ishinë prej nesh,

- dotë kishinë mbeturë me ne; po *duallnë*, që të çfaqenë se nukë janë të-gjithë prej nesh.
- 20 Edhe ju keni të-lyerë prej Shënjtit, edhe i 21 dini të-gjitha. Nuk' u shkrova juve, sepse nukë dini të-vërtetënë, po sepse e dini, edhe sepse çdo gënjeshtërë nuk' është nga e-vër-
- 22 teta. Kush është gënjeshtari, veç ay që mohon se Jisuj nuk' është Krishti? ky është' anti-
- 23 krishti, ay që mohon Atin' edhe Birinë. Kushdo që mohon Birinë, s'ka as Atinë; (ay që-rrëfen Birinë, ka edhe Atinë).
- 24 Ajo pra që ju dëgjuatë që ndë kryet, letë mbetetë ndër ju. Ndë mbettë ndër ju ajo që dëgjuatë që ndë kryet, edhe ju dotë
- 25 mbetenit te Biri e tek Ati. Edhe këta është të-zotuarëtë që ay na uzotua, jet' e-përje-
- 26 tëshme. Këto u'a shkrova juve për ata që 27 u kobonjënë. Edhe *ata* të-lyerëtë që muartë nga ay mbetetë ndër ju, edhe s'keni nevojë t'u mësonjë juve ndonjë; po sikundrë u mëson juve gjithatëtë-lyerë për të gjitha, *kështu* është edhe e-vërtetë, edhe nuk' është gënjeshtërë; edhe sikundrë u mësoj juve, dotë mbetenit mb' atë.
- 28 Edhe tashi, djemthit' *e mi*, mbetuni mb' atë, që, kur të çfaqetë, të kemi kuxim, e të mos turpëronemi nga ay mbë t'ardhurit t'ati.
- 29 Ndë e dini, se është' i-drejtë, e dini se kushdo që bën drejtërinë prej ati ka lindurë.

Krye 3.

- 1 Shihni ç'farë dashurie na ka dhënë Ati, që të quhemi djem të Perëndisë; përandaj bota nukë na njih, sepse nuk' e njohu atë.
- 2 Të-dashurë, tashi jemi djem të Perëndisë; po edhe s'është çfaqurë se ç'dotë jemi; po e dimë, se, kur të çfaqetë, do të jemi posi ay; sepse do t'a shohëm' atë sikundtë
- 3 është. Edhe kushdo që ka këtë shpresë mb' atë, pastron vetëhen' e ti, sikundrë ay është'
- 4 i-pastrëtë. Kushdo që bën fajinë, bën edhe 5 panominë; sepse faji është panomia. Edhe e dini, se ay uçfaq, që të ngrerë fajetë
- 6 t'anë; edhe faj nukë ka tek ay. Kushdo që mbetetë mb' atë, nukë fëjen; kushdo që fëjen nuk' e ka par' atë, as nuk' e ka njohur' atë.
- 7 Djemthit' *e mi*, letë mos u kobonjë juve asndonjë; ay që bën drejtërinë, është' i-drejtë,
- 8 sikundrë ay është' i-drejtë. Ay që bën fajinë, është nga djalli; sepse që ndë kryet djalli është dyke fëjyerë. Përandaj uçpërfaq i Bir' i Perëndisë, që të prishnjë punërat' e djallit.
- 9 Ay që ka lindurë prej Perëndisë, faj nukë bën, sepse fara e ati mbetetë mbë atë; edhe s'munt të fëjenjë, sepse ka lindurë prej Pe-
- 10 rëndisë. Me këtë çquhenë djemt' e Perëndisë, edhe djemt' e djallit. Kushdo që nukë bën drejtëri, nuk' është nga Perëndia, *si* edhe ay që nukë do të vëllanë.
- 11 Sepse këjo është porosia që ndëgjuatë

- 12 që ndë kryet, të duamë njëri tjetërinë; Jo sikundër Kaini i-cili ishte prej të-ligut, edhe theri të vëllanë. Edhe përse e theri atë? sepse punërat' e ati ishinë të-liga, e ato të të vëllat *ishinë* të-drejta.
- 13 Mos çuditi, vëllezërit' e mi, ndë bota u ka më-
14 ri juve. Neve e dimë, se kemi shkuarë prej vdekjesë ndë jetët, sepse duamë vëllezëritë; ay që
15 nukë do vëllanë, mbetetë ndë vdekjet. Kushdo që i ka mëri të vëllat, është njeri-vrasës; edhe e dini se çdo njeri-vrasës s'ka jetë të-përjetëshme që mbetetë ndë vetëhet të ti.
- 16 Nga këjo e njohëmë dashurin' e *Krishtit*, se ay vuri jetën' e ti për ne; edhe neve kemi detyrë të vëmë jetënë t'ënë për vëllezëritë.
- 17 Po ay që ka të-mirat' e botësë, edhe sheh të vëllanë që ka nevojë, edhe mbyll zëmërën' e ti prej ati, qysh *munt të* mbetetë dashuria
18 e Perëndisë tek ay? Djemthit' e mi, të mos duamë me fjalë, as me gjuhë, po me punë e me të-vërtetë.
- 19 Edhe nga këjo e njohëmë se jemi prej së-vërtetësë, edhe dotë sigurojmë zëmëratë
20 t'ona përpara ati; Se ndë na dënon zëmëra, *pa fjalë* Perëndia është më i-math se zëmëra
21 jonë, edhe njuh të-gjitha. Të-dashurë, ndë mos na dënon zëmëra jonë, kemi kuxim te
22 Perëndia; Edhe çdo që të lypëjmë, e marrëmë nga ay, sepse ruajmë porosit' e ati,
23 edhe bëjmë të pëlqyeratë përpara ati. Edhe

- këjo është porosia e ati, të besojmë mb' e-mërit të Birit t'ati Jisu Krisht, edhe të duamë njeri tjetërinë, sikundër na la porosi.
24 Edhe ay që ruan porosit' e ati, mbetetë mb' atë, edhe ay mbë këtë, edhe nga këjo e njohëmë se mbetetë ndër ne, nga Fryma që na dha.

Krye 4.

- 1 Të dashurë, mos i besoni çdo fryme, po provoni frymatë, ndë janë nga Perëndia; sepse shumë profitër të-rrem duallnë ndë botët. Nga këjo e njihni Frymën' e Perëndisë; çdo frymë që rrëfen, se Jisu Krishti ka ardhurë ndë mish, është nga Perëndia; Edhe çdo frymë që nukë rrëfen se Jisu Krishti ka ardhurë ndë mish, nukë është nga Perëndia; edhe këjo është *fryma* e antikrishtit, që keni dëgjuarë se vjen, edhe qe tashë është ndë botët.
- 4 Ju jeni nga Perëndia; djemthit' e mi, edhe i keni mundurë ata; sepse ay *që është* ndër ju është më i-math se ay *që është* ndë botët.
- 5 Ata prej botësë janë; përandaj prej botësë
6 flasënë, edhe bota i dëgjon ata. Neve jemi nga Perëndia; ay që njuh Perëndinë, na dëgjon; ay që nukë është nga Perëndia, nukë na dëgjon. Nga këjo njohëmë frymën' e së-vërtetësë, edhe frymën' e kobimit.
- 7 Të-dashurë, letë duamë njëri tjetërinë; sepse

- dashuria është nga Perëndia; edhe kushdo që do ka lindurë prej Perëndisë, edhe e njeh
- 8 Perëndinë. Ay që nukë ka dashuri, nuk' e njohu Perëndinë; sepse Perëndia është dashuri. Mbë këtë uçaq dashuria e Perëndisë mbë ne, se Perëndia Birin' e ti të-vetëmlindurinë e dërgoj ndë botët, që të rrojmë me
- 10 anë t'ati. Mbë këtë është dashuria, jo se neve e deshmë Perëndinë, po se ay na deshi neve, edhe dërgoj Birin' e ti çpërblim për
- 11 fajetë t'anë. Të-dashurë, ndë na deshi kështu Perëndia, edhe neve kemi detyrë të duamë njëri tjetërinë. Asndonjë s'e ka parë Perëndinë ndonjë herë. Ndë duamë njëri tjetërinë, Perëndia mbetetë ndër ne; edhe dashuria e
- 13 ati është e-sosurë mbë ne. Nga këjo e njohëmë, se mbetemi mb' atë, edhe ay ndër ne, sepse na ka dhënë nga Fryma e ti.
- 14 Edhe neve kemi parë, edhe dëshmojmë, se Ati dërgoj Birinë Shpëtimtar të botësë.
- 15 Ay që të rrëfenjë se Jisuj është i Bir' i Perëndisë, Perëndia mbetetë mb' atë, edhe ay mbë Perëndinë. Edhe neve e kemi njohur edhe e kemi besuarë dashurinë, që ka Perëndia mbë në. Perëndia është dashuri; edhe ay që mbetetë ndë dashurit, mbetetë mbë
- 17 Perëndinë, edhe Perëndia mb' atë. Mbë këtë është e-sosurë dashuria me ne, që të kemi kuxim ndë ditët të gjqyqit; sepse sikundrë ay është, kështu edhe ne jemi ndë këtë botë.

- 18 Frikë nukë ka ndë dashurit, po dashuria e-sosurë e nxier jashtë frikënë; sepse frika ka mundim; edhe ay që ka frikë nuk' është
- 20 i-mbaruarë ndë dashurit. Neve e duamë atë; sepse ay më parë na deshi. Ndë thëntë ndonjë, Se dua Perëndinë, edhe i ka mëri të vëllat, është gënjeshtar; sepse ay që s' do të vëllanë të-cilinë e ka parë, qysh munt të
- 21 dojë Perëndinë të cilinë s'e ka parë? Edhe këtë porosi e kemi nga ay, Ay që do Perëndinë, të dojë edhe të vëllanë.

Krye 5.

- 1 Kushdo që beson se Jisuj është Krishti, ka lindurë prej Perëndisë; edhe kushdo që do atë që e ka pjellë, do edhe atë që ka
- 2 lindurë prej ati. Nga këjo e njohëmë se duamë të bijt' e Perëndisë, kur duamë Perëndinë, edhe ruajmë porosit' e ati. Sepse këjo është dashuria e Perëndisë, të ruajmë porosit' e ati; edhe porosit' e ati nukë janë
- 4 të-rënda. Sepse çdo gjë që ka lindurë prej Perëndisë e munt botënë, edhe kejo është
- 5 vitoreja që mundi botënë, besa jonë. Cili është' ay që munt botënë, veç ay që beson, se Jisuj është i Bir' i Perëndisë?
- 6 Ky është' ay që erdhi me anë uji e me anë gjaku, Jisu Krishti; jo me anë uji vetëmë, po me anë uji edhe gjaku; edhe Fryma është ajo që dëshmon, sepse Fryma është e-

- 7 vërteta. Sepse tre janë ata që dëshmonjënë ndë qiellit, Ati, Fjala, edhe Frym' e-Shënjtëruarë; edhe këta të tre janë një. Edhe tre janë ata që dëshmonjënë ndë dhet, Fryma, edhe ujëtë, edhe gjaku; edhe këta të tre janë mbë një.
- 9 Ndë qoftë se presëmë dëshmimin' e njerësvet, dëshmimi i Perëndisë është më imath; se ky është dëshmimi i Perëndisë që
- 10 ka dëshmuarë për të Birinë. Ay që i beson të Birit të Perëndisë, ka dëshmimnë ndë vetëhet të ti; ay që nuk' i beson Perëndisë, gënjeshtar e ka bërë atë, sepse nuk' i besoj dëshmimit që dëshmoj Perëndia për të Birinë. Edhe ky është dëshmimi, se Perëndia na dha jetë të-përjetëshme, edhe këjo jetë
- 12 është tek i Biri. Ay që ka Birinë, ka jetëndë; ay që s' ka të Birin' e Perëndisë, s' ka jetëndë. Këto u'a shkrova juve që besoni mb'emërët të Birit të Perëndisë, që t'a dini se keni jetë të-përjetëshme, (edhe që të besoni mb'emërët të Birit të Perëndisë.)
- 14 Edhe ky është kuximi që kemi tek ay, se, ndë lypçimë gjë pas dashurimit t' ati, na
- 15 dëgjon. Edhe ndë e dimë se na dëgjon, çdo që të lypëjmë, e dimë se marrëmë të-lypuratë që kemi lypurë prej ati.
- 16 Ndë paftë ndonjë vëllan' e ti se fëjen faj jo për vdekje, dotë lypënjë, edhe *Perëndia* dot' i apë ati jetë, atyreve që nukë fëjenjënë

- për vdekje. Ka faj për vdekje; nukë them
- 17 të lutetë për atë *faj*. Çdo shtrëmbëri është faj; edhe ka faj jo për vdekje.
- 18 E dimë se kushdo që ka lindurë nga Perëndia nukë fëjen; po ay që ka lindurë nga Perëndia e ruan vetëhen' ë ti, edhe i-ligu
- 19 nuk' e përket. E dimë se jemi nga Perëndia; 20 edhe gjithë bota gjëndetë mbë të-ligët. Po e dimë se i Bir' i Perëndisë erdhi, edhe na dha kupëtim, që të njohëmë të-vërtetinë; edhe jemi mbë të-vërtetinë, mbë të Birin' e ati Jisu Krisht. Ky është i-vërteti Perëndi, edhe jeta e-përjetëshme.
- 21 Djemthit' e mi, ruani *vetëhenë t' uaj* nga idhujtë. Amin.